



REPUBLIKË SË KOSOVË	KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT	ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Is. Prot.
Dep.	Prot No.
Nr. I faq.	01-4607/13
Broj stranica	Data
Nr. pages	Datum
	31.12.2013
DREJTORI I AGJENCISË	

2-D/DPK

02



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.12.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylllet rasti me nr. AKK – 03-3989/13, për z. Flamur Keqa – Drejtor i Departamentit të Tregtisë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, për arsy se nuk ka të dhëna të mjaftueshme *që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit*.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-3989/13, për z. Flamur Keqa – Drejtor i Departamentit të Tregtisë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, dhe njëkohësisht pronar në biznesin IBF Consulting Training Sh.P.K., është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Krasniqi, së pari është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin procedurës së shqyrimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë me ç ‘rast është diskutuar lidhur me dyshimin për situatën në të cilën ndodhet për të parandaluar situatën e mundshme e konfliktit të interesit.

Në këtë takim, z. Keqa ka konfirmuar se është Drejtor i Departamentit të Tregtisë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë mirëpo ai ka thënë se funksionin e personit të autorizuar në biznesin e tij "IBF Consulting Training Sh.P.K.", e ushtron një person i besueshëm.

Pas kësaj Agjencia ka kontaktuar zyrtaret e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të cilët kanë konfirmuar një gjë të tillë.

Duke pasur parasysh këto të dhëna konstatojmë se në këtë situatë nuk ekziston konflikti i interesit.

Mirëpo, zyrtarit të lartë z. Keqa i është tërhequr vërejtja që nuk mund të jetë përfaqësues i biznesit të lartpërmendur, duke pasur parasysh nenin 16 (parografi 1 dhe 2) të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni shprehimisht parashihet që:

1. *Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhue se në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak te funksionit.*
2. *Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë veprimtari private, si; avokatisë, noterisë, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.*

II. Në pajtim me nenin 18 (parografi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

Hasan Preteni



[Handwritten signature of Hasan Preteni]